

THIRRJE PËR APLIKIM

për

Ndjekjen e programit të studimit “Siguria dhe Hetimi”, cikli i parë “Bachelor”, në Akademinë e Sigurisë, për vitin akademik 2025–2026

Të nderuara Aplikantë, në mbështetje dhe zbatim të:

- Ligjit nr. 82/2024 për “Policinë e Shtetit”;
- Ligji nr.80/2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSh”
- Rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me VKM nr.112, datë 24.02.2025;
- Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 986, datë 08.07.2025, “Për hapjen e fazës së aplikimeve për konkurrim për ndjekjen e programit të studimit ‘Siguria dhe Hetimi’, cikli i parë ‘Bachelor’, në AS, për vitin akademik 2025–2026”;
- dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi,

Policia e Shtetit dhe Akademia e Sigurisë shpallin, hapjen e fazës së aplikimeve për ndjekjen e programit të studimit “Siguria dhe Hetimi”, cikli i parë “Bachelor”, pranë Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit, në Akademinë e Sigurisë, për vitin akademik 2025–2026.

Për këtë vit akademik Senati Akademik, në zbatim të ligjit 80/2015 të “Arsimit të lartë”, miratoi hapjen e **150 kuota të lira**, të cilat janë të dedikuara për shtetasit që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë dhe që dëshirojnë të ndjekin këtë program studimi, me synim përgatitjen dhe formimin profesional për punësim në strukturat e Policisë së Shtetit, në rolin e parë drejtues.

a- KRITERET E PRANIMIT

Të drejtë aplikimi kanë shtetasit shqiptarë që plotësojnë të gjitha kriteret e mëposhtme:

1. Të kenë shtetësi shqiptare.
2. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar.
3. Të jenë në gjendje të mirë shëndetësore.
4. Të kenë kryer arsimin parauniversitar brenda ose jashtë vendit, i njohur ose ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
5. Të zotërojnë gjuhën shqipe, me shkrim dhe me gojë.
6. Të mos jenë të dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë, për kryerjen e një krimi apo kundërvajtjeje penale me dashje.
7. Të kenë filluar procedurat për pajisjen me dëshmi të aftësisë për drejtimin e automjetit të tipit “B”.
8. Të plotësojnë kriteret e besueshmërisë dhe integritetit.
9. Të kenë notën mesatare të arsimit të mesëm të lartë jo më pak se 6.5.
10. Të jenë në moshë jo më shumë se 30 vjeç në ditën e fillimit të vitit akademik.
11. Të kenë gjatësinë trupore jo më pak se 170 cm për meshkuj dhe jo më pak se 160 cm për femra.
12. Të mos jenë të përjashtuar nga Policia e Shtetit, struktura të tjera të sigurisë kombëtare, ose të kenë qenë larguar nga shërbimi civil.

b- AFATET DHE PROCEDURAT E APLIKIMIT

1. Periudha e aplikimit online: **29 korrik – 03 gusht 2025**.
2. Aplikimi kryhet në portalin U-Albania, duke zgjedhur programin e studimit “Siguria dhe Hetimi”.
3. Aplikantët duhet të shkarkojnë dokumentacionin e mëposhtëm nga faqja zyrtare e Policisë së Shtetit dhe ta dorëzojnë fizikisht në momentin e regjistrimit paraprak:
 - a. Formularin e aplikimit;
 - b. Kërkesën model tip;
 - c. Formularin e vetëdeklarimit;
 - d. Skedën shëndetësore të plotësuar nga qendra shëndetësore sipas vendbanimit;
 - e. Fotokopje të kartës së identitetit;
 - f. Certifikatë familjare.
4. Regjistrimi dhe dorëzimi i dokumentacionit fillestar: **05 – 06 gusht 2025** pranë Akademisë së Sigurisë.
5. Nëse gjatë verifikimit rezulton se aplikanti nuk plotëson kriteret, ai skualifikohet nga procesi dhe njoftohet me email mbi arsyet e skualifikimit.

c- PROCESI I VLERËSIMIT, TESTIMIT DHE KONTROLLIT

Aplikantët do t’i nënshtrohen një procesi vlerësimi dhe konkurrimi që përfshin:

Lloji i vlerësimit	Pesha në total
Nota mesatare e shkollës së mesme	50% e vlerësimit të përgjithshëm (5 pikë për çdo notë)
Testi fizik	30% e vlerësimit të përgjithshëm
Intervista me gojë	20% e vlerësimit të përgjithshëm
Testi psikologjik	Kalues/Jo kalues
Kontrolli shëndetësor	I aftë/Jo i aftë

- Testi fizik zhvillohet në datat 07 – 10 gusht 2025.
- Intervista me gojë dhe testi psikologjik zhvillohen në datat 11 – 14 gusht 2025.
- Kontrolli shëndetësor zhvillohet në datat 18 – 22 gusht 2025.

Përveç vlerësimeve të mësipërme, aplikantët i nënshtrohen edhe verifikimit të besueshmërisë, përfshirë krahasimin e gjurmëve daktiloskopike sipas procedurave standarde të Policisë së Shtetit.

d- PUBLIKIMI I REZULTATEVE

- **Më datë 25 gusht 2025**, Komisioni i Pranimi harton listën e rezultateve të aplikantëve dhe shqyrton vërtetimet e besueshmërisë dhe informacionet e dërguara nga Instituti i Policisë Shkencore.
- **Më datë 26 gusht 2025**, lista e renditjes publikohet në mjediset e AS-së dhe ngarkohet në portalin U-Albania, duke përdorur vetëm ID-në e Maturës për të ruajtur të dhënat personale të aplikantit.

- **Fitues shpallen** vetëm aplikantët e renditur brenda 150 kuotave të para të shpallura.

e- ANKIMIMI

Për çdo fazë të procesit të përzgjedhjes, duke filluar nga momenti i shpalljes së thirrjes për aplikim e deri në shpalljen e rezultateve, kandidatët kanë të drejtë të paraqesin ankesa, të cilat shqyrtohen nga Komisioni i Apelimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Ankimet mbi rezultatet dorëzohen brenda datës 27 gusht 2025, në njërin nga mënyrat e mëposhtme:

- a. **fizikisht**, pranë sekretarisë së Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, kundrejt protokollit të dorëzimit;
- b. **me postë**, në adresën: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
- c. **në formë elektronike**, në adresën zyrtare të e-mailit: burimet.njerezore@asp.gov.al.

Komisioni i Apelimit shqyrton dhe merr vendim mbi ankesat në datat 28 – 29 gusht 2025.

Rezultatet përfundimtare të procesit shpallen më datë 29 gusht 2025.

f- REGJISTRIMI PËRFUNDIMTAR

- Regjistrimi i aplikantëve fitues kryhet në periudhën 29 gusht – 11 shtator 2025.
- Në momentin e regjistrimit, aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentacionin shtesë që përfshin:
 - a. Certifikatë të gjendjes gjyqësore;
 - b. Diplomë dhe listë notash të noterizuar;
 - c. Vërtetim që është i regjistruar për marrjen e lejes së drejtimit të automjetit të tipit “B”, apo lejes së drejtimit të automjetit të tipit “B” të noterizuar;
 - d. Vërtetim nga gjykata që nuk është në proces gjykimi;
 - e. Vërtetim nga prokuroria që nuk është në ndjekje penale;
 - f. Vërtetim nga SPAK që nuk është objekt hetimi.

g- DETYRIMET E STUDENTËVE

- a. Studentët e pranuar në AS, do të nënshkruajnë kontratë me institucionin, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet gjatë shkollimit, si dhe detyrimi për të shërbyer jo më pak se 3 (tre) vite në strukturat e Policisë së Shtetit pas diplomimit.
- b. Gjatë periudhës së studimeve, ata trajtohen sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave për pagat dhe shpërblimet për punonjësit e Policisë së Shtetit.

h- INFORMACION SHITESË

- Të gjitha informacionet mbi thirrjen për aplikim, kriteret, dokumentacionin e nevojshëm, videot e testimit fizik dhe udhëzimet për procedurat do të publikohen në faqet zyrtare të Policisë së Shtetit dhe Akademisë së Sigurisë:

- Web: www.asp.gov.al
- E-mail: info@asp.gov.al

Përzgjedhja nga ana Juaj do t'ju bëjë pjesë të trupës studentore në auditorët e Akademisë së Sigurisë e cila:

- a. është pjesë e sistemit të arsimit të lartë në RSh, me parametrat akademik të kërkuar në zbatueshmëri të kërkesave të “Kornizës Shqiptare të Kualifikimit”.
- b. është akredituar nga ASCAL-i, si “Institucion i Arsimit të Lartë” sipas sistemit evropian për vitet Akademike 2023-2028;
- c. ka të akredituara programet e studimit cikli i parë “Bachelor”, “Siguria dhe Hetimi”, për vitet akademike 2024-2027;
- d. është akredituara sipas sistemit IADLEST-ShBA, për vitet akademike 2024-2027;
- e. është përzgjedhur nga Qendra e Trajnimeve Federale ShBA (FLETC) si “Qëndër rajonale për trajnimin e liderit të lartë policor”;
- f. është antarësuar në rjetin e Akademive të shteteve anëtare të INTERPOL-it;
- g. Ministria e Arsimit dhe Sporteve ka miratuar, hapjen e nivelit të dytë “Master Shkencor në fushën e Sigurisë dhe Hetimit” në Akademinë e Sigurisë për vitin akademik 2025-2027.

Ftoj të gjithë të rinjtë e të rejtat, të interesuar dhe që plotësojnë kriteret, kërkesat e përcaktuara më sipër të aplikojnë brenda afateve të shpallura më lartë për të qenë pjesë e Akademisë së Sigurisë për të ndërtuar një karrierë të suksesshme në shërbim të rendit dhe sigurisë publike!

Ju mirëpresim!